V E N D I M
Nr.188, datë 25.4.1995

PËR SHKËPUTJEN NGA PUNA TË SPORTISTËVE, GJYQTARËVE, TRAJNERËVE E VËZHGUESVE NË DITËT E VEPRIMTARIVE SPORTIVE

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Sportistët, gjyqtarët, trajnerët e vëzhguesit që janë punonjës në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, lejohen të shkëputen nga puna për ditët e veprimtarive sportive kombëtare e ndërkombëtare. Pagesa për ditët e grumbullimit do të bëhet nga institucioni që e organizon veprimtarinë. Numri i punonjësve joefektivë që do të grumbullohen, nuk do të përfshihet në numrin e punonjësve të miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Për mbulimin e shpenzimeve do të përdoren fondet e miratuara në buxhetin e shtetit dhe të ardhura të tjera.

2. Federata sportive, me miratimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, u njihet e drejta të grumbullojë sportistët e trajnerët për veprimtari ndërkombëtare të çdo sporti 15 ditë para veprimtarisë, por jo më shumë se 30 ditë pune të pagueshme në vit.

Pagesa për ditët e grumbullimit të bëhet nga federata që organizon grumbullimin.

3. Për nxënësit dhe studentët që marrin pjesë në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, mungesat e shkaktuara nga pjesëmarrja në këto veprimtari konsiderohen të justifikuara dhe nuk ndikojnë në numrin e përgjithshëm të mungesave.

4. Për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzim të veçantë.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.87, datë 7.5.1974 dhe nr.311, datë 29.7.1987, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi